VENDIM
Nr. 217, datë 17.4.2019

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË POLONISË, PËR PUNËSIMIN NË PUNË FITIMPRURËSE TË ANËTARËVE TË FAMILJES SË NJË ANËTARI TË NJË MISIONI DIPLOMATIK APO KONSULLOR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Kryeministrit dhe ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Polonisë, për punësimin në punë fitimprurëse të anëtarëve të familjes së një anëtari të një misioni diplomatik apo konsullor, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË POLONISË PËR PUNËSIMIN NË PUNË FITIMPRURËSE TË ANËTARËVE TË FAMILJES SË NJË ANËTARI TË NJË MISIONI DIPLOMATIK APO KONSULLOR

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Polonisë, në vijim referuar si "Palët",

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1
Autorizim për të ndjekur punësim fitimprurës

Anëtarët e familjes që janë pjesë e familjes së anëtarit të misionit diplomatik apo postit konsullor të Republikës së Shqipërisë në Republikën e Polonisë dhe anëtarët e familjes që janë pjesë e familjes së anëtarit të misionit diplomatik apo postit konsullor të Republikës së Polonisë në Republikën e Shqipërisë, do të autorizohen, mbi baza reciproke, për t'u angazhuar në një punësim fitimprurëse në shtetin pritës, në përputhje me ligjin e atij shteti dhe dispozitat e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 2
Përkufizimet

Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje:

1) "Punësim fitimprurës" do të thotë çdo formë punësimi tjetër me pagesë, si të vetëpunësuar ose si punonjës, duke përfshirë trajnimin profesional ose përmbushjen e një funksioni në bordin e një personi juridik që kryen veprimtari biznesi.

2) "Një anëtar i një misioni diplomatik apo posti konsullor" do të thotë një punonjës i Shtetit dërgues që kryen funksionet e një agjenti diplomatik, nëpunësi konsullor ose anëtar i personelit administrativ dhe teknik të misionit diplomatik apo të postit konsullor në shtetin pritës, në përputhje me përcaktimet e përfshira në nenin 1 shkronja "e" dhe "f" të Konventës së Vjenës mbi Marrëdhëniet Diplomatike të datës 18 prill 1 961 dhe në nenin 1 paragrafi 1, shkronja "d" dhe "e" të Konventës së Vjenës mbi Marrëdhëniet Konsullore të 24 prillit 1963, i cili nuk është shtetas i shtetit pritës dhe nuk e posedon të drejtën e qëndrimit të përhershëm në të:

3) "Anëtar i familjes" nënkupton personin e mëposhtëm që është pjesë e familjes dhe i varur nga një pjesëtar i misionit diplomatik apo postit konsullor të Shtetit dërgues:

a) bashkëshort/e;

b) fëmijë nën 21 vjeç;

c) fëmijë nën 25 vjeç, i cili ndjek me kohë të plotë studimet në një institucion arsimor pas shkollës së mesme;

d) fëmijë me paaftësi fizike ose mendore që është i paaftë për t'u kujdesur për veten e tij/saj.

Neni 3

Procedurat

1. Nëse një anëtar i familjes dëshiron të angazhohet në një punë fitimprurëse në Shtetin pritës, Ambasada e Shtetit dërgues duhet të paraqesë një kërkesë të përshtatshme me shkrim pranë Protokollit Diplomatik të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shtetit pritës.

2. Kërkesa e përmendur në paragrafin 1 duhet të identifikojë anëtarin e familjes, i cili dëshiron të angazhohet në punë fitimprurëse në shtetin pritës dhe duhet të përmbajë një përshkrim të shkurtër të pozicionit që ai/ajo synon të zërë, informacion në lidhje me punëdhënësin potencial dhe çdo informacion tjetër të kërkuar nga autoritetet kompetente të shtetit pritës, në përputhje me ligjin e tij të brendshëm.

3. Protokolli diplomatik i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shtetit pritës, pas konfirmimit se anëtari i familjes në fjalë i plotëson kushtet e shtjelluara në këtë Marrëveshje, do të informojë Ambasadën e Shtetit tjetër, sa më shpejtë që të jetë e mundur, se anëtari i familjes në fjalë mund të angazhohet në punësim fitimprurës në territorin e Shtetit pritës.

4. Anëtari i familjes do të përjashtohet nga detyrimi për të marrë një leje punësimi në punë fitimprurëse në shtetin pritës, përveç lejes së parashikuar në paragrafin 3.

Neni 4

Imunitet nga juridiksioni civil dhe administrativ

Nëse anëtarë të anëtarit të familjes, gëzojnë imunitet nga juridiksioni civil dhe administrativ i Shtetit pritës në përputhje me Konventën e Vjenës, 18 prill 1961, mbi marrëdhëniet diplomatike apo me Konventën e Vjenës për Marrëdhëniet Konsullore të vitit 1963, ose çdo marrëveshje tjetër ndërkombëtare të ratifikuar nga Palët, ky imunitet nuk do të zbatohet lidhur me çdo veprim apo mosveprim në lidhje me punësimin fitimprurës.

Neni 5

Imunitet nga juridiksioni penal

Nëse anëtarët e familjes, të autorizuar për t'u angazhuar me punë fitimprurëse, gëzojnë imunitet ndaj juridikionit penal në përputhje me Konventën e Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike të vitit 1961,ose ndonjë marrëveshje tjetër ndërkombëtare në fuqi të ratifikuar nga Palët:

a) Shteti dërgues do marrë në shqyrtim seriozisht çdo kërkesë të Shtetit pritës për heqjen e imunitetit të juridiksionit penal të anëtarit të varur nga familja, akuzuar për kryerjen e një krimi, ose në lidhje me një veprim apo mosveprim që rezulton në përgjegjësi penale në lidhje me punësimin fitimprurës të personin nën varësi përveçse në rrethana të veçanta në të cilat shteti

dërgues konsideron se heqja dorë është kundër interesave të tij. Kur imuniteti nuk është hequr anëtari i familjes do të humbas të drejtën për punësim fitimprurës dhe do t'i kërkohet të lërë territorin e Shtetit pritës.

b) Heqja e imunitetit ndaj juridiksionit penal nuk do të kuptohet se mund të zgjatet deri në vuajtjen e një dënimi, për të cilin qëllim do të kërkohet një dokument i veçantë i heqjes dorë. Në raste të tilla, Shteti dërgues do të studiojë seriozisht heqjen e këtij imuniteti të dytë.

Neni 6

Regjimet fiskale dhe sigurimet shoqërore

Anëtari i familjes i angazhuar në punë fitimprurëse do t'i nënshtrohet dispozitave për tatimin mbi të ardhurat, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore në fuqi në Shtetin pritës në lidhje me çdo çështje që ka të bëjë me angazhimin në punësim fitimprurës në këtë shtet.

Neni 7

Njohja e kualifikimeve

1. Kjo Marrëveshje nuk e lejon një anëtar të familjes për t'u angazhuar në punë fitimprurëse në pozicione që sipas ligjit të brendshëm të shtetit pritës mund të mbahen vetëm nga shtetasit e atij shteti.

2. Kjo Marrëveshje nuk parasheh mundësinë që anëtarët e familjes të kërkojnë njohje automatike të kredencialeve profesionale të tyre, titujve shkencorë dhe/ose kualifikimeve të tjera. Njohja e tyre do të kryhet në përputhje me ligjin e brendshëm të shtetit pritës.

Neni 8

Ndërprerja e autorizimit

1. Ambasada e Shtetit dërgues do të informojë protokollin diplomatik të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shtetit pritës në lidhje me çdo ndryshim në statusin e anëtarit të familjes të angazhuar në punë fitimprurëse.

2. Leja për angazhim në punë fitimprurëse nga ana e anëtarit të familjes, të parashikuar në nenin 3 paragrafi 3, do të jetë e vlefshme deri në ditën:

1) kur një anëtar i familjes humbet statusin e tij/saj, në përputhje me nenin 2, pika 3; ose

2) e përfundimit apo mbarimit të kontratës së punës së anëtarit të familjes apo kontratë tjetër për angazhimin në punë fitimprurëse ose

3) e mbarimit të detyrës në shtetin pritës të anëtarit të misionit diplomatik apo postit konsullor nga i cili varet statusi i atij anëtari të familjes.

3. Ndryshimi në punësim fitimprurës nga ana e anëtarit të familjes kërkon leje të re në përputhje me procedurat dhe rregullat e parashikuara në nenin 3.

Neni 9

Ndryshimet

Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj Marrëveshjeje mund të bëhen me njoftim me shkrim nëpërmjet kanaleve diplomatike, me pëlqimin e ndërsjellë të palëve, të formuluara në protokolle të veçanta, si pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje, që do të hyjnë në fuqi në përputhje me dispozitat e nenit 11.

Neni 10

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë në lidhje me këtë Marrëveshje do të zgjidhet nëpërmjet kanaleve diplomatike, me anë të negociatave të drejtpërdrejta midis palëve.

Neni 11

Hyrja në fuqi dhe kohëzgjatja

1. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditë pas datës së marrjes, nëpërmjet kanaleve diplomatike, të njoftimit të fundit në të cilin Palët njoftojnë njëra-tjetrën për përfundimin e procedurave të tyre të brendshme ligjore të nevojshme për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

2. Kjo Marrëveshje lidhet për një kohëzgjatje të pakufizuar.

3. Secila Palë mund ta përfundojë këtë Marrëveshje përmes njoftimit nëpërmjet kanaleve diplomatike. Në një rast të tillë, Marrëveshja do të përfundojë pas 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditësh nga data e marrjes së njoftimit të përfundimit.

Bërë në Varshavë, më 28. 2., dy mijë e 19 në dy ekzemplarë, secili në gjuhën shqipe, polake, dhe angleze, të gjitha tekstet janë të barasvlershme. Në rast të ndonjë mospërputhjeje në interpretimin e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, do të mbizotërojë teksti në anglisht.

PËR KËSHILLLIN
E MINISTRAVE TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS SË POLONISË